



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS

**VENDIM**  
**Nr. 33, datë 6.7.2022**

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR FUNKSIONIMIN E  
SISTEMIT QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISAR)”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.76, datë 18.12.2014, i ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 16, pika 2, shkronja “a” shfuqizohet.

b) Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 3, shkronja “b” ndryshon me përmbajtje si vijon:

*“të ketë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes së tërthortë të personave juridik sipas Shtojcës 2 kur llogaria e titullit hapet nga Banka e Shqipërisë ose të ketë lidhur kontratë kujdestarie me një pjesëmarrës tjetër të drejtpërdrejtë”.*

ii. pika 4 shfuqizohet.

c) Në nenin 26, pika 2, shkronja “b” ndryshon me përmbajtje si vijon:

*“llogaria omnibus (1) që është llogaria e hapur në emër të pjesëmarrësit dhe ku depozitohen titujt e zotëruar nga klientët e pjesëmarrësit. Llogaritë omnibus kategorizohen sipas natyrës së klientit, sipas përcaktimit në Shtojcën 21”.*

- d) Në nenin 28, pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me përmbajtje si vijon:  
*“3/1. Dita e regjistrimit për ngjarjet e pagesave është:*
- a) 1 (një) ditë pune përpara datës së pagesës në monedhën vendase;*
  - b) 3 (tre) ditë pune përpara datës së pagesës në monedhën e huaj“.*
- e) Në nenin 50 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. në pikën 3, fjalia e parë riformulohet me përmbajtje si vijon:  
*“Ministria përkatëse për Financat përjashtohet nga komisionet.”.*
  - ii. Pika 5/1 ndryshon me përmbajtje si vijon:  
*“Komisionet për:*
    - a) operacionet e veçanta, shlyhen në bazë ditore, në ditën e nesërme të punës;*
    - b) pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë sipas pikës 4, shlyhen automatikisht brenda tremujorit të parë të vitit ose të anëtarësimit;*
    - c) pjesëmarrësit e tërthortë sipas pikës 4, shlyhen pas njoftimit të Administratorit brenda tremujorit të parë të vitit ose të anëtarësimit.*

*Administratori mund t’i dërgojë pjesëmarrësve në ditën e parë të punës të muajit kalendarik, një faturë përmbledhëse për komisionet e paguara në muajin paraardhës.”*
- f) Në shtojcën 1, neni 7, shkronja “b” ndryshon me përmbajtje si vijon:  
*“Llogari omnibus sipas përzgjedhjes nga lista e Shtojcës 21 të Rregullores. Lista e llogarive omnibus është pjesë integrale e kontratës dhe mund të ndryshojë pas njoftimit me shkresë nga përfaqësuesi i pjesëmarrësit në këtë kontratë dhe konfirmimit nga përfaqësuesi i Administratorit.”*
- g) Shtojcat 3 dhe 4 shfuqizohen.
- h) Në shtojcën 6, pika 2, shkronja “b” ndryshon sipas përmbajtjes së Aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
- i) Në Shtojcën 7, pas tabelës shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:  
*“Në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar sipas përcaktimeve në rregulloren “Për minimumin e rezervës së detyruar mbajtur nga bankat pranë Bankës së Shqipërisë”, DVP cut-off kryhet në orën 16:15.”*
- j) Shtojca 8, ndryshon sipas përmbajtjes së Aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.
- k) Në Shtojcën 11, paragrafi II shfuqizohet.
- l) Pas Shtojcës 20, shtohet Shtojca 21 sipas përmbajtjes së Aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

- m) Emërtimi “Ministria e Financave” zëvendësohet në të gjithë tekstin e rregullores me emërtimin “*Ministria përkatëse për Financat*”.
2. Në pikën 1, shkronjat “a”, “b” nën pika ii, “e”, nën pika i, “g” dhe “k” të këtij vendimi, hyjnë në fuqi në 1 janar 2023.
  3. Të gjitha shkronjat përbërëse të pikës 1, përveç atyre të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, hyjnë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë ditë) pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
  4. Pjesëmarrësit e sistemit AFISaR, për zbatimin e pikës 1, shkronja “c” të këtij vendimi, duhet të kryejnë veprimet brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e ndryshimeve sipas pikës 3 të tij. Kostot e këtyre veprimeve do të rimbursohen nga Administratori i sistemit AFISaR.
  5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.
  6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me botimin e këtij vendimi përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Elvis ÇIBUKU**

**Gent SEJKO**

## ANEKS

### Shkronja “b” e pikës 2 të Shtojcës 6

#### Mesazhet njoftuese

<i>Tipi i mesazhit</i>	<i>Përshkrimi</i>
<i>MT 599</i>	<i>Mesazh përshkrues</i>
<i>MT 548</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>• <i>Njoftimi për përputhjen e instruksioneve (Gjenerohet automatikisht nga sistemi, por mund të zgjidhet edhe mos marrja e këtij mesazhi).</i></li><li>• <i>Njoftimi për refuzimin e instruksionit ku përfshihet edhe arsyeja e refuzimit.</i></li></ul>
<i>MT535</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>• <i>Njoftim për gjendjen e titujve në llogarinë e mbajtësit.</i></li></ul>
<i>MT564</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>• <i>Njoftim për ngjarjet e pagesave.</i></li></ul>
<i>MT566</i>	<ul style="list-style-type: none"><li>• <i>Konfirmim për ngjarjen e pagesave.</i></li></ul>

## Shtojca 8: Komisionet e aplikuara në sistemin AFISaR

Lloji i komisioneve	Në vlerë (lekë)	Në për qindje
<b>A. Komision për anëtarësim dhe mirëmbajtje</b>		
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e tërthortë	0 (zero)	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për çdo llogari për pjesëmarrësit e tërthortë (persona juridikë) me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë për çdo llogari omnibus të kategorive A, B, C dhe D	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë për çdo llogari omnibus të kategorive E,F,G,H,I	a- 0 (zero) në qoftë se pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë zotëron llogari omnibus të kategorive A,B,C,D; b- 250,000 në rast se pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë nuk zotëron asnjë llogari omnibus të kategorive A,B,C,D.	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për Bursën e Titujve	100,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë me llogari titulli në pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë përveç Bankës së Shqipërisë*	150,000	
Komision daljeje	0 (zero)	

<b>B. Komision për operacionet e veçanta</b>		
Komision (1) procesimi për operacionet DVP (shitje/blerjet, kredi brenda ditës me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i kthimit, marrëveshje riblerjeje/ të anasjellta riblerjeje me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i anasjelltë )	350	
Komision (2) procesimi për operacionet DVP ( marrëveshje riblerjeje/ të anasjellta riblerjeje dhe transaksioni i anasjelltë të ndryshme nga ato me Bankën e Shqipërisë)	200	
Komision procesimi për operacionet FOP (transfertat e portofolit, transaksionet midis llogarisë vetjake të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe llogarisë së një pjesëmarrësit të tërthortë që është klient i të njëjtit pjesëmarrës së drejtpërdrejtë, transaksionet midis dy pjesëmarrësve që kanë të njëjtin agjent shlyerës në AIPS, ekzekutimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje riblerjeje, transaksionet për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes)	350	
Komision për procesimin e rezultateve të tregut primar (emetim, maturim, ankand rihapjeje, ankand për blerjen mbrapsht të titullit)	200	
Komision për operacionet e netimit sipas modelit DVP2 për transaksionet e tregut primar	150	
Komision për procesimin e pagesës së interesave të përfituara nga investimi në tituj	1200	
Komision për procesimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar (regjistrimi i kolateralit, lirimi i kolateralit)	350	

Komision për kthimin e kuponave nga rishitësi tek riblerësi në një marrëveshjerepo/reverse repo	350	
Komision për riciklimin e transaksioneve të tregut primar	0 (zero)	
Komision për procesimin e operacioneve që rrjedhin nga thirrja e titujve, nga ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/ të anasjellta riblerjeje të Ministrisë përkatëse për Financat, nga taksimi i titujve	0 (zero)	
<b>C. Komisione të tjera</b>		
Përgatitja e raporteve sipas kërkesës specifike	Për t'u vlerësuar në bazë të kërkesës specifike	
Komisione për trajnimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për certifikimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për pajisjen e aksesit në sistemin AFISaR	3 (tre) për pjesëmarrës falas, të tjerat me pagesë sipas kostos së pajisjes. Për institucionet/organet pajisja është me pagesë.	
Komision për kërkimin e informacionit nga Institucioni/Organi	0 (zero)	
<b>D. Zbritjet për të inkurajuar procesimin</b>		
Për vëllimin e procesuar	0 (zero)	
Për kohën e procesimit	0 (zero)	

\*Ky komision i faturohet dhe mbledhet nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dhe më pas i transferohet Bankës së Shqipërisë.

## Shtojca 21: Kategoritë e llogarive omnibus

	<b>Kategoria</b>	<b>Identifikimi i omnibusit bazë</b>	<b>Lloji i investitorit që do përfshihet në omnibus</b>
A	Person fizik (individë)	0001ii	Do të depozitohen titujt në pronësi të personave fizikë (rezident dhe jo rezident)
B	Biznes i regjistruar jo financiar	0001rb	Do të depozitohen titujt në pronësi të kompanive me aktivitet jo financiar
C	Fonde pensioni	0001pf	Do të depozitohen titujt në pronësi të fondeve të pensionit vullnetar
D	Biznes i regjistruar jorezident	0001nr	Do të depozitohen titujt në pronësi të kompanive (financiare dhe jo-financiare) që nuk janë rezidente
E	Ndërmjetës financiarë	0001fa	Do të depozitohen titujt në pronësi vetjake të institucioneve financiare jo banka dhe shoqërive komisionere rezidente që kryejnë ndërmjetësim në tregun e kapitaleve.
F	Fonde investimi	0001if	Do të depozitohen titujt në pronësi të klientëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive
G	Shoqëritë e sigurimit	0001ic	Do të depozitohen titujt në pronësi të shoqërive të sigurimit, shoqërive të risigurimit dhe ndërmjetësve në sigurime
H	Klientë të ndërmjetësve financiarë	0001bs	Do të depozitohen titujt në pronësi të klientëve të ndërmjetësve financiarë
I	Shoqata fondacione	0001np	Do të depozitohen titujt në pronësi të shoqatave, fondacioneve, OJF-ve e të tjerave me natyrë të ngjashme